



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Kërkuesi **Prokuroria e Posaçme kundër Korruptionit dhe Krimit të Organizuar** më datë **02.09.2024** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Vleftësimin e ndalimit dhe caktimin e masës së sigurimit ndaj personit nën hetim **Gentian Bako**, në kuadër të procedimit penal Nr.92 të vitit 2024”.

2. Në përfundim të gjyqimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtare Elsa Ulliri, bazuar në nenet 228, 229, 230, 238, 253, 259 të K.Pr.Penale, me vendimin Nr.111, datë **03.09.2024**, vendosi:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës.
2. Vleftësimin e paligjshëm të ndalimit të personit nën hetim **Gentian Bako**.
3. Caktimin e masës së sigurimit personal “Detryimi për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”, për personin nën hetim Gentian Bako, në bazë të nenit 234 i K.Pr.Penale, duke urdhëruar të ndaluarin të paraqitet në policinë gjyqësore pranë prokurorisë, çdo të merkurë, ora 14:00.
4. Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i të ndaluarit Gentian Bako nga ambientet e paraburgimit nqs nuk mbahet i ndaluar, i arrestuar apo i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale.
5. Urdhërohet Prokuroria e Posaçme kundër Korruptionit dhe Krimit të Organizuar dhe Policia Gjyqësore për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar brenda 5 ditëve, duke filluar ky afat nga e nesërmja e komunikimit të vendimit.

Tiranë, më datë 03.09.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar